



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 703 Prot.

Durrës, më 5.4.2024

VENDIM

Nr 30, datë 5.4, 2024

PËR

**"SHPLLJEN E ZGJEDHJEVE TË REJA PËR ANËTARË TË KOMISIONIT
INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE DHE HAPJEN E PROÇEDURAVE PËR
APLIKIM PËR KOMISION APELIMI, NË UNIVERSITETIN
"ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë", të vendimit të Senatit Akademik nr.29 datë 29.03.2024 për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", neni 6 dhe neni 39, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Shpalljen e zgjedhjeve të reja për anëtarë të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve dhe hapjen e procedurave për aplikim për Komision Apelimi, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Kandidatët staf akademik për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve vetëkandidohen dhe dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:
 - Kërkesën për kandidim (formulari bashkëlidhur);
 - Kopjen e dokumentit të identifikimit;
 - Vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore (formulari bashkëlidhur).
3. Kandidatët student duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:
 - Kërkesën për Kandidim, (bashkëlidhur), shoqëruar nga të paktën 30 firma të studentëve qe mbështesin kandidaturën;
 - Vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore(formulari bashkëlidhur);
 - Kopje të dokumentit të identifikimit.
4. Kandidatët për anëtar të Komisionit të Apelimit duhet të përmbushin kriteret dhe dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:
 - Kanë përvojë pune në mësimdhënie jo më pak se 5(pesë) vjet, me kohë të plotë;

- Nuk kanë qënë asnjëherë të dënuar për vepra penale të formës së prerë;
 - Nuk kanë lidhje gjinore në vijë të drejtë ose të tërthortë, deri në shkallë të katërt, me kandidatët që konkurojnë në zgjedhje;
 - Dorëzojnë kërkesën për kandidim (formulari bashkëlidhur);
 - Dorëzojnë kopjen dokumentit të identifikimit;
 - Dorëzojnë vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore (formulari bashkëlidhur).
5. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar për kandidim, sekretaria e Senatit Akademik pasi konfirmon të dhënat për stafin akademik me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, dhe të dhënat e studentëve që kandidojnë me kryesekretaritë e fakulteteve përkatëse, përcjell listën e kandidaturave të regjistruara për votim në Senatit Akademik.
6. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë Sekretarisë së Senatit Akademik është nga data 8.4.2024 deri me datë 12.4.2024.
7. Për zbatimin e këtij vendimi mgarkohen:
- Dekanët e Fakulteteve
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Durrës, më __ / __ /2024

FORMULAR APLIKIMI
PËR ANËTAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur
më __/__/____, në _____, student në vitin _____ dega _____
Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të qenë anëtar i Komisionit
Institucional të Zgjedhjeve.

Emër, Mbiemër/ Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Durrës, më __ / __ /2024

FORMULAR APLIKIMI
PËR ANËTAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur
më __/__/__, në _____, staf akademik me kohë të plotë në Departamentin
_____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të
qenë anëtar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve.

Emër, Mbiemër/ Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Durrës, më __/__/2024

FORMULAR APLIKIMI
PËR ANËTAR I KOMISIONIT TË APELIMIT

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur
më __/__/__, në _____, staf akademik me kohë të plotë në Departamentin
_____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të
qenë anëtar i Komisionit të Apelimit.

Emër, Mbiemër/ Nënshkrimi

FORMULAR VETEDEKLARIMI

Te dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri	
Atësia, Mëmësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (nje kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lire se jam :

i/e padënuar i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRESI I VETEDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë

Autorizim : Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta

dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale ne vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22. 07. 1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.